



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
-Kuvendi i Komunës-

01Nr.02-104/02-30953/20
Kaçanik, 24.12.2020

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 24 Dhjetor 2020, pos tjerash, u;

INFORMUA

1. Për zbatimin e Planit të Integritetit të Komunës së Kaçanikut për vitin 2019, me tekstin e mëtejme “ Raport i përmbushjes së Planit të Integritetit të Komunës së Kaçanikut për vitin 2019”

2. Në materialin si në pikën 1 të kësaj shkrese, paraqitet gjendja faktike e implementimit të Planit të Integritetit e Komunës së Kaçanikut për vitin 2019, identifikimin e rreziqeve të cilat mund të dëmtojnë imazhin e Komunës si dhe rezultatet e arritura gjatë vitit.

3. Pjesë përbërëse e kësaj shkrese, është; Raporti i përmbushjes së Planit të Integritetit të Komunës së Kaçanikut për vitin 2019.

Më këtë shkresë njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemajl Merseli





14.12.2020



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data	14.12.20	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë		
02	104/02-30953	-1.		

R A P O R T

I PËRMBUSHJES SË PLANIT TË INTEGRITETIT TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT PËR VITIN 2019

DHJETOR 2020

Përmbajtja

HYRJE	3
PJESA E PARË , Funksionet e përgjithshme të komunës	4
Sistemi i menaxhimit financiar, regjistrimi dhe menaxhimi i aseteve	4
Menaxhimi i burimeve njerëzore	4
Auditimi i brendshëm	5
Prokurimi publik	5
PJESA E DYTË , Etika dhe Integriteti	6
Konflikti i interesit	6
Mospërputhja e funksioneve	6
Deklarimi i pasurisë	6
Integriteti i përgjithshëm dhe transparenca	7
PJESA E TRETË , Funksionet e veçanta të komunës	8
Kabineti i Kryetarit	8
Marrëdhëniet me publikun	8
PËRMBLEDHJE	9

HYRJE

Në kuadër të punës së përditshme që kanë institucionet publike, në këtë rast Komuna e Kaçanikut, rëndësi të veçantë i kushtohet imazhit dhe besimit që gëzon ky institucion në raport me qytetarët të cilët i përfaqëson. Kur bëjmë fjalë për imazhin dhe besimin, atëherë forma më e mirë që këto dy komponentë kryesor të aplikohen është që të implementohet në saktësi plani i integritetit që është aprovuar nga Kuvendi i Komunës.

Qëllimi kryesor përveç raportimit vjetor është vetëdijesimi i zyrtarëve publik me obligimet ligjore që kane në raport me qytetarët si dhe kërkesat e tyre ndaj institucioneve. Ruajtja dhe promovimi i imazhit të mirë në masë të publikut është shndërruar në sfidë mjaft të madhe për ne. Angazhimi në këtë segment është kurorëzuar me suksese të njëpasnjëshme siç janë raporti pozitiv i auditimit, përfitimi i grantit të performancës etj. Këto suksese janë treguesi më i mirë se institucioni të cilin ne drejtojmë është në rrugë të duhur, ku përfitues janë të gjithë banorët të cilët jetojnë në Komunën e Kaçanikut.

Natyrisht se objektivi i punës në institucione publike mund të shpie deri te veprimet ditore të zyrtarëve/funksionarëve publik që mund të dëmtojnë imazhin e komunës. Mirëpo për këtë arsye është hartuar Plan i Integritetit 2019-2021. Ashtu siç precizohet në plan, përveç që synohet ruajtja e integritetit, ndër qëllimet kryesore është forcimi i besueshmërisë dhe lidhjes ndërmjet qytetarëve dhe institucionit.

Nëpërmjet këtij raporti do të pasqyrohet gjendja faktike e çështjes së implementimit të Planit të Integritetit për vitin 2019.

Metodologjia për grumbullimin e të dhënave për hartimin e këtij raporti është fokusuar në të dhënat që vijnë nga personi i emëruar për zbatimin e Planit të Integritetit 2019-2021. Përfshirë këtu edhe fushat e rrezikut dhe analizimi i të dhënave në Raportin Vjetor për vitin 2019. Përpunimi i këtyre tre komponentëve na ka dhënë mundësinë që të raportojmë në baza vjetore rreth zbatimit (ose jo) të planit në fjalë. Sidoqoftë, të dhënat e brendshme fuqizohen në masë të madhe edhe nga të dhënat apo raportet që hartohen në baza vjetore nga institucionet e jashtme.

Përbërja e këtij raporti do të ndahet në tri pjesë. Në pjesën e parë do të raportohet lidhur me grupin e parë të fushave të precizuara në Planin e Integritetit 2019-2021, të cilat përfshijnë funksionet e përgjithshme të komunës. Pjesa e dytë shtjellon çështjet të cilat në plan janë klasifikuar në grup të dytë dhe kanë të bëjnë kryesisht me etikën dhe integritetin dhe në pjesën e tretë do të raportohet për funksionet e veçanta të komunës.

PJESA E PARË, FunkSIONET e përgjithshme të komunës

Sistemi i menaxhimit financiar, regjistrimi dhe menaxhimi i aseteve sipas planit, kjo fushë e rrezikut është definuar në këtë formë: “Sistemi i menaxhimit të financave, regjistrimi dhe menaxhimi i aseteve nuk janë të efektshme si dhe mungojnë kontrollet”.

Bazuar në Rregulloren MF - Nr. 02/2017 për alokimin e fondeve e cila përcakton procesin për alokimin e fondeve sipas LMFP-së dhe Ligjit vjetor për Buxhetin e Republikës së Kosovës, në fillim të vitit 2019 është përgatitur Kesh Plani akumulativ për të gjitha programet, nën-programet e Organizatës Buxhetore – Komuna Kaçanik, është finalizuar sipas ndarjeve buxhetore të Ligjit të Buxhetit dhe planifikimit për zotimin përkatësisht shpenzimin e tyre. Kesh Plani final i përgatitur është dorëzuar në FTP Serverin e Thesarit sipas udhëzimeve të Thesarit.

Në afate të rregullta tre mujore janë hartuar raporte mbi shpenzimin e buxhetit komunal, të cilat janë dërguar në Kuvendin Komunal për diskutim dhe shqyrtim të mëtejshëm. Për të arritur një transparencë buxhetore, gjitha raportet e hartuara kanë përmbajtur shënime të hollësishme apo analitika për shpenzimet e ndodhura. Llojet e raporteve të hartuara dhe shpalosura për publikun e gjerë janë: TM1/2019; TM2/2019; TM3/2019 dhe Raporti Vjetor Financiar 2019.

Bazuar në Rregulloren e MF – NR. 02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në organizatat buxhetore, është bërë regjistrimi i pasurisë jofinanciare (vlera mbi 1000 euro. Investimet kapitale ishin nga më të ndryshmet, duke filluar me rregullimin dhe asfaltimin e rrugëve, rregullimin e ujërave të zeza, rregullimin trotuareve, rregullimin e urave, rregullimin e ndriçimit publik, investimet në palestrën sportive, rregullimin e ujit të pijshëm si dhe shumë projekte tjera të cilat u investuan dhe u regjistruan si pasuri komunale.

Në kuadër të bashkëfinancimit të projekteve kapitale me Ministritë e ndryshme të Republikës së Kosovës, në koordinim me disa prej tyre si: Ministria e Kulturës dhe Sportit, Ministria e Arsimit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit, Ministria e Infrastrukturës, etj. Ministritë financuese dhe janë siguruar dokumentet e nevojshme për regjistrim të këtyre projekteve si pasuri e komunës.

Nga të dhënat që janë marrë nga raporti vjetor, raporti i inventarizimit, të dhënat e sinjalizuesit si dhe të dhënat tjera, vlerësohet se në këtë fushë të rrezikut të paraparë sipas planit, është punuar dhe janë parandaluar veprimet e ndryshme që shpijnë në mungesë kontrolli ose mungesë efikasiteti.

Menaxhimi i burimeve njerëzore

Në këtë fushë të rrezikut, theks kryesor sipas planit vihet tek mungesa e kontrollit. Gjatë vitit 2019, zyra e burimeve njerëzore ka zhvilluar të gjitha procedurat e nevojshme konform ligjeve dhe rregulloreve në koordinim të plotë ndërmjet kryetarit, drejtorive dhe sektorëve tjerë komunal. Gjithashtu janë trajtuar me kohë dhe në afat optimal të gjitha ankesat nga palët e ndryshme në procedurë. Për këtë arsye, integritetit të lartë i jep formë pikërisht interesimi dhe përkushtimi i kësaj zyre në zbatimin e parimeve të duhura në këtë fushë.

Auditimi i brendshëm

Në Planin e Integritetit 2019-2021 si dhe në funksionimin e përgjithshëm të institucionit komunal, me rendësi shumë të madhe vlerësohet zyra e auditimit të brendshëm. Kjo zyrë përveç funksionit "ex-officio" që ka, i kushton rendësi të veçantë edhe fushës së integritetit të institucionit.

Si fushë potenciale e rrezikut potencohet mungesa e efikasitetit dhe kontrollit. Mirëpo, bazuar në raporte dhe të dhënat që posedojmë, auditimi i brendshëm i komunës vlerësohet ndër çështjet me të rëndësishme dhe trajtohet me seriozitetin më të madh në të gjitha rastet që i ngritë ose ka për synim t'i trajtojë kjo zyre. Prandaj, vlerësojmë se në këtë segment ka kontrollë të mjaftueshëm si dhe ka pavarësi të plotë në ushtrimin e detyrës zyrtare.

Prokurimi publik

Në kuadër të prokurimit publik, si sektor shumë i rëndësishëm i raporteve mes komunës dhe operatorëve ekonomik, gjithnjë me qëllim të udhëheqjes së procedurave tenderuese tek investimet kapitale apo mallrave dhe shërbimeve, me planin e integritetit kemi vërejtur si fushë të rrezikut potencial "mungesën e kontrollit dhe transparencën e dobët".

Nëpërmjet krijimit të mekanizmave ligjor si dhe ngritjes së kontrollit të vazhdueshëm të udhëheqësit më të lartë administrativ të komunës, kemi arritur që të gjitha njoftimet, kontratat, dhe prokurimet e ndryshme t'i bëjmë transparente.

Ky fakt dëshmohet nga realiteti që përgjegjësit e zyrës së prokurimit i publikojnë njoftimet vazhdimisht në ueb-faqen zyrtare të Agjencisë Qendrore të Prokurimit (<https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNew.aspx> si dhe në ueb-faqen zyrtare <https://kk.rks-gov.net/kacanik/category/prokurimi/?page=2019> .

PJESA E DYTË, Etika dhe Integriteti

Konflikti i interesit

“Konflikti i interesit është situata e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, ku zyrtari ka interes privat, direkt ose indirekt, që ndikon, mund të ndikojë ose duket sikur ndikon në realizimin e gabuar të funksionit publik, në situata të shkeljes së mundshme të parimeve, të kufizimeve apo detyrimeve të tjera zyrtare”. Në mbështetje të këtij përkufizimi, synimet në bazë të planit të integritetit për vitin 2019, ishin që zyrtarët të njoftohen me situatat kur mund të shfaqet konflikti i interesit.

Vazhdimisht jemi në interes të përkushtimit në zbatim të ligjeve dhe rregulloreve të cilat si rezultat kanë ngritjen e integritetit komunal. Për këtë, deklarimin e pasurisë përsëri e kemi futur në Planin e Integritetit për vitet 2019-2021. Thjesht, konsiderojmë se kemi nevojë që vazhdimisht të mësojmë mbi rreziqet të cilat i kanosen shoqërisë nëpërmjet dukurive negative, që në fakt ndikojnë në imazhin e përgjithshëm të Komunës së Kaçanikut.

Mospërputhja e funksioneve

Mospërputhja e funksionit është gjendja e mospajtimit kur një profesionist që mban një zyre angazhohet në të tjera profesione apo aktivitete që synojnë të sigurojnë të ardhura pa aprovimin paraprak të punëdhënësit, ose që nuk përfshin aktivitete pedagogjike, shkencore, hulumtuese, artistike, kulturore, sportive dhe aktivitete botuese ose aktivitete të tjera të parashikuara me një tjetër ligj.

Bazuar në këtë fushë të rrezikut, vlen të përmendim se në administratën komunale të gjithë zyrtarët publik, e bëjnë punën e tyre në mënyrë profesionale dhe nuk ka mospërputhje të funksionit. Secili zyrtar publik, ushtron veprimtarinë sipas kushteve të akt-emërimit dhe përshkrimit zyrtar të detyrave të punës. Në disa raste, zyrtarët publik kryejnë edhe detyra tjera të cilat nuk kalojnë 10% të angazhimit të përgjithshëm të tij/saj. Çdo drejtori apo sektor, është i planifikuar në kuadër të organogramit dhe çdo nëpunës ka edhe zëvendësin e tij në rast të pushimit. Kjo bëhet me qëllim që qytetarët dhe zyrtarët publik mos të shpëputen në marrjen e shërbimeve të ndryshme dhe puna të zhvillohet në konsistencë.

Deklarimi i pasurisë

Mospërputhja e deklarimit të pasurisë së kërkuar është gjendja kur një profesionist që mban një zyre i kërkohet me ligj të raportojë dhe të komunikojnë pasuritë e tij/saj subjekteve përkatëse pas marrjes apo ndërprerjes për të mbajtur një post publik.

Nga të dhënat zyrtare që posedojmë, kjo çështje rregullohet nëpërmjet Agjencionit Kundër Korrupsionit. Rrjedhimisht, të gjithë zyrtarët që mbajnë post publik dhe kanë për obligim deklarimin e pasurisë, e bëjnë këtë në mënyrë të rregullt dhe nuk është paraqitur asnjë problem përgjatë vitit 2019.

Duhet vënë në pah se përgjatë vitit 2019, nuk është iniciuar asnjë rast korruptiv ose pranim të dhuratave të dyshimta që kapin vlerë të madhe nga zyrtarët publik.

PJESA E TRETË, Funksionet e veçanta të komunës

Kabineti i Kryetarit

Te fusha e rrezikut që ndërlidhet kryekëput me Kabinetin e Kryetarit, rreziku potencial është definuar në këtë formë: "Kabineti i Kryetarit si menaxhment i lartë nuk e mbështet rolin udhëheqës, koordinimi nuk është efikas në arritjen e pajtueshmërisë dhe koherencës në pjesët e komunës për të cilat ata kanë përgjegjësi".

Kryetari i Komunës ka vërejtur si fushë potenciale të rrezikut dhe për këtë arsye ka forcuar mekanizmin e zingjirit komandues. Unifikimi i Kabinetit të Kryetarit të Komunës me një qëllim të vetëm që është zhvillimi i komunës, janë arritur rezultate mjaft të mira sidomos në implementimin dhe menaxhimin e projekteve kapitale.

Kryetari i Komunës është përkujdesur që pjesë e kabinetit të tij të jenë persona adekuat, profesional dhe të pranueshëm për masën. Në këtë kontekst, është krijuar ambient i favorshëm i punës ku gjithsecilit iu ndahen përgjegjësitë dhe se të gjithë janë të gatshëm t'i ndihmojnë njeri-tjetrit në arritjen e objektivave të cilat i cakton pikërisht ai.

Bashkëpunimi i ndërsjellë i sektorëve dhe drejtorive ka dhënë rezultatet e veta. Është ngritur performanca e përgjithshme e komunës, janë dëgjuar kërkesat dhe ankesat e qytetareve, janë aplikuar masa të nevojshme në ngritjen e cilësisë së shërbimeve etj. Me fjalë tjera, kabineti i kryetarit është i obliguar që të funksionoj si trup unik, me qëllimin e vetëm që zhvillimi i politikave lokale të jetë në harmoni me kërkesat e qytetarëve dhe si të tilla t'i përgjigjen atyre në çdo kohë. Në anën tjetër, delegimi i kompetencave tek stafi mbështetës, në këtë rast te drejtorët e drejtorive komunale, është mëse i nevojshëm sepse rritë performancën e drejtorive dhe njëkohësisht rritë efikasitetin në zgjidhjen e çështjeve të caktuara.

Marrëdhëniet me publikun

Si shumë fusha tjera të rrezikut të paraqitura sipas Planit të Integritetit 2019-2021, edhe kjo fushë vë në pah mungesën potenciale të kontrollit si dhe efikasitetin. Si nën fusha përmendet edhe nëpunësit jo kompetent në zyrën për marrëdhënie me publikun dhe ngjashëm.

Për të parandaluar denigrimin e integritetit përsa i përket kësaj fushe, Komuna e Kaçanikut ka zgjedhur kryetarët e këshillave të fshatrave sipas rregullores. Ky hap, ndër tjerash ka kontribuar në krijimin e një hapësire më të gjerë përsa i përket publikut dhe qytetarëve.

Komuna e Kaçanikut, nëpërmjet zyrës së informimit por edhe nëpërmjet kanaleve tjera, ka informuar publikun për secilën ngjarje e që përfshihen konsultimet lidhur me rregullore, investimet kapitale, debatet për buxhetin etj.

Në këtë formë, janë bërë përpjekjet që çdo informatë që ka të bëjë me masën e gjerë, të delegohet te ai, çoftë nëpërmjet rrjeteve sociale ose çoftë nëpërmjet ueb-faqes apo njoftimet nëpërmjet telefonit.

Duhet thënë se përgjatë vitit 2019, janë përdorur shume mënyra për të krijuar marrëdhëniet të cilat vijnë me parime të mirë-informimit dhe transparencës për punët që bëjnë komuna.

PËRMBLEDHJE

Përveç fushave të rrezikut që u përmendën më lartë, në Planin e Integritetit për vitin 2019-2021 janë edhe shume segmente tjera të cilat kanë rëndësi jetike për funksionimin mirëfilltë të Komunës së Kaçanikut. U përmend në fillim që sipas Planit të Integritetit 2019-2021, emërohet zyrtari për zbatimin e planit të integritetit. Ky zyrtar, fatmirësisht për vitin 2019, nuk ka raportuar për asnjë shkelje eventuale që dëmton imazhin dhe integritetin e Komunës së Kaçanikut. Këtë fakt e mbështesin edhe qëndrimet tjera siç janë raportet hulumtuese nga OJQ-të, raporti i auditorit të përgjithshëm etj.

Kontrolli, disiplina, shpërndarja e përgjegjësisë, parimi i subsidiaritetit, llogaridhënia etj, janë detyrat e përditshme që për synim kanë implementimin e reformave graduale në administratën publike me synim kryesor të përafrimit me vendet e Bashkimit Evropian.

Në hyrje të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, thuhet: "Të bindur se ekzistenca e bashkësive lokale (komunave) të veshura me përgjegjësi efektive mundëson një drejtim njëherazi efikas e nga afër të qytetarit". Duke u mbështetur në këtë parim, angazhimi ynë ishte dhe do të vazhdojë të jetë në shërbim të qytetarëve të Komunës së Kaçanikut, me theks të veçantë në ngritjen e vazhdueshme të integritetit institucional.



Drejtori i DAP

Festim Neziraj

Integriteti i përgjithshëm dhe transparencia

Në planin e Integritetit të Komunës 2019-2021, si fushë potenciale që ndikon në mos funksionim të mirëfilltë të komunës është mungesa e transparencës. Për këtë arsye, kjo çështje është ndër shtyllat themelore të cilat i ka caktuar qeverisja lokale si prioritet.

Siç e kemi nënvizuar në informatën për vitin 2018, sërish i kemi dhënë rëndësi të madhe integritetit dhe transparencës. Këto janë dy komponent të rëndësishëm që shërbejnë si masë treguese lidhur me performancën komunale në nivel të Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim, Qeveria e Kosovës nëpërmjet MAPL-së, ka krijuar Sistemin për Menaxhimin e Performancës së Komunave (SMPK).

Ky sistem, ndër tjerash, theks të veçantë i jep disa fushave raportuese e ku ndër më kryesoret janë ato që ndërlidhen me transparencë. Përqindja e arritur e performancës në këtë fushë është 100%. Të gjitha mbledhjet e kuvendit komunal ishin bërë publike dhe po ashtu pas verifikimit u konstatua se mbledhjet e kuvendit ishin postuar në ueb faqen e komunës.

Komuna ka raportuar se nga shumë kërkesa të qytetarëve për qasje në dokumente publike në komunë, gjatë vitit komuna ofroi qasje në të gjitha dokumentet e kërkuara nga qytetarët.

Komuna në ueb-faqen e saj ofron të dhëna të përditësuara për veprimtaritë publike të saj. Por ashtu komuna ka raportuar se ofron qasje online në strategji dhe dokumente tjera të politikave në fushë veprimtarinë e institucionit publik. Komuna kishte paraqitur planin vjetor të prokurimit publik. Vendimet e kuvendit të komunës dhe të kryetarit të gjitha po ashtu janë publike. Komuna ka publikuar të gjitha kontratat të lidhura me kompani aq sa ishin gjithsej gjatë vitit 2019.